



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 34, datë 09.10.2020

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZONJËS SONILA BEJTJA NË VENDIN VAKANT
PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I
REPUBLIKËS NË DATËN 22.11.2019**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Fiona Papajorgji	- Anëtare
Arta Marku	- Anëtare
Miranda Andoni	- Anëtare/relatore
Saida Dollani	- Anëtare
Ludovik Dodaj	- Anëtar
Fatjona Memçaj	- Anëtare

Asistuar nga sekretare Dorina Dulaj,

Me praninë e Avokatit të Popullit, përfaqësuar me autorizim nga z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- z. Bledar Dervishaj, përfaqësues i autorizuar i Presidentit të Republikës,
- znj. Katrin Treska, përfaqësuese e autorizuar e Presidentit të Republikës,
- znj. Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës 09.10.2020 mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATI PËR GJYQATAR
NË GJYKATËN KUSHTETUESE:**

Zonja Sonila Bejtja

OBJEKTI:

**Urdhërimi i lejimit të kandidimit të
zonjës Sonila Bejtja në vendin vakant për
gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur
nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.**

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtarit të Këshillit, zonjës Miranda Andoni, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, nëpërmjet përfaqësuesit me autorizim z. Enio Haxhimihali, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë*”. Presidenti i Republikës, në datën 22.11.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar në datën 15.01.2020, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 “*Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion*”, si edhe të pikës 4 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Miranda Andoni.

4. Zonja Sonila Bejtja, si një ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për t’u paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Sonila Bejtja, gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

5. Në datën 22.01.2020, kandidatja Sonila Bejtja është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit, si dhe me autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidates të deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

6. Në datën 24.01.2020, kandidatja Sonila Bejtja ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularët e deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të

procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikës 60 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 34 prot., datë 30.01.2020, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 8577/2000 dhe ligjit nr. 115/2016.

8. Bashkëlidhur kësaj shkrese, drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe deklarata e nënshkruar nga kandidatja Sonila Bejtja, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidates për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

9. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 1112/5 prot., datë 06.03.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Sonila Bejtja dhe personat e lidhur me të. Rezultatet e kontrollit janë të pasqyruara në shkresën 136/26 prot., datë 06.03.2020, gjithsej 32 faqe.

10. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, edhe Këshilli ka kryer veprimet verifikuese të kërkitimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave për pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidates Sonila Bejtja dhe personave të lidhur me të.

11. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidates Sonila Bejtja, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 18.02.2020 i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit) si vijon:

- a) Institucione bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k., (5) Final sh.a., (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sh.a., (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e

Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sh.a., (17) Union Financiar Tiranë.

- c) Subjekte financiare të licencuara nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike, si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

12. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara më sipër kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara për pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Sonila Bejtja.

13. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikës 82 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 35 prot., datë 30.01.2020, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Sonila Bejtja sipas ligjit nr. 138/2015.

14. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 211/317 prot., datë 02.06.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Sonila Bejtja. Bashkëlidhur kësaj shkrese ndodhet vendimi datë 01.06.2020 *“Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Sonila Riza Bejtja”*.

15. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Sonila Bejtja, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikës 84 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 37 prot., datë 30.01.2020*) dhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 38 prot., datë 30.01.2020*).

16. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka dërguar përgjigje me shkresën nr. 583 prot., datë 28.02.2020, ndërsa Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 360/4 prot., datë 09.09.2020.

17. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të neneve 229 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe të pikës 85 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 36 prot., datë 30.01.2020, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Sonila Bejtja për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

18. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 137/5 prot., datë 17.02.2020, ka dërguar vendimin nr. 214, datë 13.02.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatën Sonila Bejtja.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikave 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 91/93 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Sonila Bejtja në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

20. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.07.2020 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatën Sonila Bejtja.

21. Gjithashtu, Këshilli i ka dërguar shkresën nr. 192 prot., datë 12.08.2020 Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke i kërkuar një listë të plotë të partive politike dhe adresat e tyre përkatëse. Me shkresën nr. 1456/1 prot., datë 14.08.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka paraqitur listën e partive politike të regjistruara pranë tij për çdo lloj zgjedhje gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Sipas listës së partive politike të vëna në dispozicion nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Këshilli ka kërkuar nga secila parti politike informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatën Sonila Bejtja.

22. Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi t'i drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekteve private pranë të cilave kandidatja Sonila Bejtja ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatës Sonila Bejtja. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka dërguar shkresë Dhomës Kombëtare të Noterëve për të kërkuar informacion lidhur me vjetërsinë në detyrë të kandidatës Sonila Bejtja dhe nëse ka masa disiplinore të marra ndaj saj (*shkresa nr. 170 prot., datë 24.07.2020*). Gjithashtu i ka dërguar shkresë edhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë për të marrë informacion për vjetërsinë në punë dhe nëse ka apo jo masa disiplinore kandidatja Sonila Bejtja (*shkresa nr. 191 prot., datë 12.08.2020*).

23. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Dhoma Kombëtare e Noterisë (*shkresa nr. 2866 prot., datë 29.07.2020*). Gjithashtu, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë (*shkresa nr. 200 prot., datë 19.08.2020*).

24. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, *Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezultoi se

kandidatja Sonila Bejtja ka përfunduar studimet e larta në *Università Degli Studi* di Milano, *Facoltà di Giurisprudenza*, duke marrë titullin “*Dottore in giurisprudenza*”. Periudha e studimit është tetor i vitit 1994 – qershor i vitit 2000.

25. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht si të përfunduar procesin e verifikimit, anëtarja e Këshillit dhe njëkohësisht edhe relatorja e çështjes, znj. Miranda Andoni, ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës për gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

26. Në zbatim të pikës 33 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 05.10.2020, ora 13:00, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të zonjës Sonila Bejtja për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019 dhe vendimmarrja në lidhje me këtë kandidim.

27. Në zbatim të pikës 34 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatës Sonila Bejtja.

28. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori për veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

29. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 09.10.2020, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

30. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

31. Në mbledhjen e datës 05.10.2020 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi gjatë shqyrtimit të gjetjeve për këtë kandidatë, bazuar në nenin 50, pika c të Vendimit nr. 4 të KED-së “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*” vendosi vijimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës të znj. Sonila Bejtja, lidhur me plotësimin e kushtit të parashikuar nga shkronja “b” e nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000 të ndryshuar.

32. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me email-in e datës 06.10.2020 i ka kërkuar kandidatës që të sjellë vërtetim për njohjen dhe njehsimin e Diplomës (“*Dottore in giurisprudenza*”) së lëshuar nga Università Degli Studi di Milano, Facoltà di Giurisprudenza. Kandidatja ka paraqitur më datë 06.10.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një kopje të legalizuar të diplomës dhe të përkthyer në gjuhën Shqipe, një kopje të origjinalit të listës së notave të noterizuar dhe një kopje të noterizuar të Vërtetimit të Njohjes dhe Njësimit Nr. 1045, datë 22.12.2017 i Komisionit

të Njohjes së Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka marrë në dorëzim këto akte me procesverbalin Nr. 287 Prot., datë 06.10.2020.

33. Në përfundim edhe të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit të lartpërmendura, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit Nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit Nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht si të përfunduar procesin e verifikimit, anëtarja e Këshillit dhe njëkohësisht edhe relatorja e çështjes, znj. Miranda Andoni, ka proceduar me përgatitjen e relacionit përfundimtar mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

34. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, zv. Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 09.10.2020, ora 14:00, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të zonjës Sonila Bejtja, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019 dhe vendimmarrja në lidhje me këtë kandidim.

35. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin përfundimtar të përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatës Sonila Bejtja.

36. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

37. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 09.10.2020, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

38. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

39. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli kërkoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatës Sonila Bejtja.

40. Në thelb, Avokati i Popullit parashtrroi se nuk ka pyetje dhe komente në lidhje me procedurën e ndjekur.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

41. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidiatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e

kandidimit të kandidatës Sonila Bejtja për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

42. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

43. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

44. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, si dhe parashtrimin e kandidatës Sonila Bejtja, sipas të cilës ajo ka ushtruar veprimtaritë profesionale si:

a) Avokate pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhoma e Avokatisë Tiranë për periudhën prill 2001 – janar 2011;

b) Notere pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë për periudhën prill 2011 dhe aktualisht.

45. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën 37 më sipër, Këshilli konstaton se përvoja e punës së kandidatës ka konsistuar në ushtrimin e veprimtarisë profesionale të avokatit dhe atë të noteres. Sipas pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës, kandidati që kërkon të zgjidhet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, ndërmjet të tjerave, duhet të plotësojë kushtet që lidhen me (a) 15 vjet përvojë pune dhe (b) ushtrimin e kësaj përvoje si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike.

46. Këshilli vlerëson se është detyrë e tij të analizojë natyrën juridike të veprimtarisë profesionale të ushtruar nga kandidatja dhe në këtë kuptim nëse ajo përfshihet në përvojat e punës që parashikohen në dispozitat kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura. Për këtë qëllim, gjatë këtij vlerësimi Këshilli mban në konsideratë si qëndrimet e mëparshme të tij¹, ashtu edhe opinionin e Komisionit të Venecias, i cili në përfundimet e tij thekson se *“është me rëndësi jetike për Shqipërinë që të ripërtërijë sa më shpejt Gjykatën Kushtetuese”*².

47. Këshilli vëren se kandidatja ka ushtruar fillimisht profesionin e avokates pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, dega Dhoma e Avokatisë Tiranë. Konkretisht, sipas shkresës nr. 200 prot., datë 19.08.2020 të Dhomës Kombëtare të Avokatisë rezulton se kandidatja, znj. Sonila Bejtja, ka ushtruar këtë profesion prej vitit 2001 deri në janar të vitit 2011, ndërsa nga muaji janar 2011 e në vijim figuron në regjistrin e avokatëve pasivë. Në lidhje me këtë veprimtari si nga raporti i ILDKPI-së, ashtu edhe nga përgjigjet e ardhura në Këshill nga D.P.Tatimeve dhe nga QKB-ja, rezulton po ashtu se kjo kandidatë ka ushtruar profesionin e avokatit (në raport evidentohen të ardhurat nga ky aktivitet), si dhe fakti që kandidatja ka qenë e pajisur me NIPT që prej datës 24.03.2004 dhe ka paguar detyrimet tatimore përkatëse.

48. Bazuar në sa më sipër, Këshilli konstaton se ushtrimi i veprimtarisë profesionale “të avokatit” është shprehimisht i parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si përvojë pune që duhet të ketë kandidati për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj Këshilli vlerëson se veprimtaria që ka ushtruar kandidatja si avokate do të konsiderohet si përvojë pune në përputhje me parashikimin kushtetues dhe ligjor të lartpërmendur, për kohën që ajo ka qenë e regjistruar në organet tatimore (nga data 24.03.2004 deri në janar të viti 2011) sipas legjislacionit në fuqi.

49. Gjithashtu, Këshilli vëren se prej vitit 2011 deri në momentin e kandidimit kandidatja ka ushtruar profesionin e noteres pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë. Konkretisht, nga shkresa nr. 2866 prot., datë 29.07.2020 e Dhomës Kombëtare të Noterisë drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezulton se kandidatja Sonila Bejtja, e cila është e licencuar si notere, ka ushtruar funksionin e noteres nga muaji prill 2011 dhe aktualisht. Edhe për këtë profesion si në raportin e ILDKPI-së së kandidatës, ashtu edhe nga përgjigjet e ardhura në Këshill nga D.P.Tatimeve dhe nga QKB-ja, rezulton se ajo ka qenë e regjistruar pranë organeve tatimore, sipas ligjit.

50. Këshilli konstaton se ushtrimi i veprimtarisë profesionale “të noteres” nuk është shprehimisht i parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si përvojë pune që duhet të ketë kandidati për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Këshilli çmoi ta diskutonte dhe vlerësonte nëse kjo përvojë pune duhet të përfshihet në veprimtaritë profesionale që Kushtetuta parashikon që duhet të kenë kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, duke iu referuar tashmë edhe qëndrimeve të mëparshme të Këshillit të

¹ Shih vendimet nr.102, 103, 104 dhe 105, të datës 30.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

² Opinioni i Komisionit të Venecias “Mbi emërimin e anëtarëve të gjykatës kushtetuese”, Strasbourg, 19 qershor 2020 CDL-AD(2020)010 * Opinion Nr. 978/2020 Or. Engl.

Emërimeve në Drejtësi mbi këtë çështje, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Këshilli ka në vëmendje dhe rithekson rëndësinë që kanë për ngritjen emergjente dhe bërjen sa më shpejt funksionale të Gjykatës Kushtetuese, rekomandimet dhe konkluzionet e opinionit të Komisionit të Venecias, të lartpërmendur.

51. Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi u përmbahet edhe qëndrimeve të tij të mëparshme se *qëllimi primar* që kërkohet për respektimin e kushteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji, pra përvoja e punës 15-vjeçare për kandidatët për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe ushtrimi i kësaj përvoje si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, është *veprimtaria e spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës*. Kjo do të thotë se synimi dhe orientimi i normës kushtetuese është përfshirja në Gjykatën Kushtetuese e atyre juristëve “*të cilët kanë treguar një nivel të lartë të profesionalizmit dhe që do i shërbejnë cilësisë së vendimmarrjes së Gjykatës, si autoriteti më i lartë në Republikën e Shqipërisë, e cila bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës dhe zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese*”.

52. Mbi këtë këndvështrim Këshilli në mënyrë permanente ka mbajtur qëndrimin se kushtetutëbërësi ka pasur si qëllim që në Gjykatën Kushtetuese të përfshijë edhe ata juristë me veprimtari nga sfera të tjera të së drejtës, të cilët me veprimtarinë e tyre kanë demonstruar njohje dhe interpretim shumë të mirë të ligjeve. Pikërisht për të vlerësuar spikatjen e kandidatit dhe vlerat e tij profesionale në fushën e së drejtës publike, gjykojmë që nuk shërben vetëm përfshirja dhe/ose klasifikimi i tij/i saj në profesione të caktuara, por edhe aftësia, si dhe performanca e kandidatit në ushtrimin e detyrave në shërbim të publikut në disiplina të ndryshme të së drejtës publike.

53. Po ashtu, Këshilli vlerëson se profesioni i noterit, sipas ligjit, është një funksion i pavarur, me karakter publik, në shërbim të personave fizikë dhe juridikë, i cili ushtrohet nëpërmjet hartimit të akteve juridike dhe ushtrimit të veprimtarive noteriale të tjera të parashikuara në ligj (neni 4 i ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”), pra një veprimtari e një rëndësie të patjetërsueshme për publikun. Edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se “*tek noteri spikatin edhe disa karakteristika thelbësore që e bëjnë noterinë një veprimtari publike nga karakteri dhe rëndësia e saj. Ofrimi i shërbimeve nga veprimtaria noteriale, ka rëndësi të veçantë për shoqërinë. Rëndësi ka edhe për institucionet shtetërore dhe publike vlera e dokumentacionit noterial. Veprimtaria noteriale shërben për vendosjen e aktiviteteve e interesave të qytetarëve mbi baza plotësisht ligjore dhe në mënyrë të unifikuar, duke siguruar shmangien e konflikteve e duke sjellë stabilitet në qarkullimin civil. Ofrimi për publikun i shërbimeve noteriale lidhet ngushtë me garancinë për një pasqyrim të besueshëm të fakteve apo të vullnetit të shprehur në veprimet që kryejnë qytetarët. Nga ana tjetër, veprimtaria noteriale krahas publikut ka rëndësi të veçantë edhe për institucionet shtetërore, sepse ky shërbim duhet t’i sigurojë atyre një dokumentacion të besueshëm, të një vlefshëm dhe pjesë përbërëse e të rëndësishme të sistemit të dokumentacionit shtetëror e publik. Duke qenë i tillë, dokumentacioni noterial është i sigurt për vërtetësinë e të dhënave të përfaqësuar, duke pasur vlerën e provës së plotë edhe në veprimtarinë gjyqësore*”. Gjykata Kushtetuese gjithashtu ka theksuar se “*funksioni i noterit në thelb është një funksion publik i “deleguar”, qëllimi i të cilit është që të realizohet një shërbim i pavarur, i paanshëm, profesional e konfidencial në autentifikimin e një kategorie mjaft të rëndësishëm dokumentesh*”³.

³ Shih vendimin nr.3, datë 19.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

54. Për pasojë, nisur nga natyra e këtij profesioni, lloji i detyrave që noteri kryen, zbatimi i veprimtarisë në të mirë dhe në funksion të publikut, Këshilli vlerëson se veprimtaria profesionale e noterit përfshihet në kategorinë e një *veprimtarie të spikatur në fushën e së drejtës*. Prandaj, Këshilli vlerëson se kandidatja duke qenë se ka një përvojë të kombinuar si në profesionin e avokatisë, ashtu edhe në atë të noterisë, me përvojën e saj profesionale ka plotësuar parashikimet e pikës 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr.8577/2000.

55. Në përfundim të analizës së veprimtarive profesionale të ushtruara nga kandidatja Sonila Bejtja, rezultoi se ajo ka së paku 15 vjet përvojë pune si avokate dhe notere. Kështu që Këshilli vjen në përfundim se kandidatja përmbush kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

56. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115.2015, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI-ja, me shkresën nr. 1112/5 prot., datë 06.03.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Sonila Bejtja dhe personat e lidhur me të. Rezultatet e kontrollit janë në dokumentin nr. 136/26 prot., datë 06.03.2020, gjithsej 32 faqe.

57. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë të kandidates Sonila Bejtja, ILDKPKI-ja në raportin e paraqitur, ka ardhur në përfundimet se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

58. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruar nga kandidatja Sonila Bejtja në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* që ka depozituar pranë ILDKPKI-së, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara më lart këtij vendimi, si dhe shpjegimet dhe dokumentacionin shtesë të paraqitur nga kandidatja.

59. Mbi bazën e verifikimeve të kryera, Këshilli i rezultoi se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruar apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklarimet e bëra nga kandidatja Sonila Bejtja pranë ILDKPKI me *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë*.

60. Gjithashtu, Këshilli e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI-ja, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave privatë të kandidates Sonila Bejtja.

61. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të Nenit 235 të ligjit Nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatet Sonila Bejtja ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të Nenit 235 të ligjit Nr. 115/2016, kjo kandidatet nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

62. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidatja Sonila Bejtja ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit, sipas Ligjit Nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

63. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën Nr. 211/317 Prot., datë 02.06.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatet Sonila Bejtja. Kështu rezulton se me Vendimin *“Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Sonila Riza Bejtja (Ibrahimi)”* datë 01.06.2020 është vendosur të miratohen rezultatet e verifikimit si më poshtë:

- a) *Nuk rezultoi e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar;*
- b) *Nuk rezultoi e dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjdhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;*
- c) *Nuk rezultoi e ndaluar/e arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare për kryerjen e një vepre penale;*
- d) *Ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.*

64. Nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatet Sonila Bejtja, krahas plotësimit të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *“ç” të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kjo kandidatet nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

65. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidatja Sonila Bejtja ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”* parashikuar në ligjin nr. 45/2015, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

66. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 137/5 prot., datë 17.02.2020 ka dërguar vendimin Nr. 74, datë 13.02.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatet Sonila Bejtja, duke ardhur përfundimet ndër të tjera se:

- a) *Sonila Riza Bejtja (Ibrahimi)...nuk figurojnë të ketë materiale, dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tyre, sipas Nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.”.*

67. Nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatet Sonila Bejtja, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji Nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991. Për rrjedhojë, lidhur me këtë kriter, në zbatim të Nenit 236 të ligjit Nr. 115/2016, kjo kandidatë nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

68. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidatja Sonila Bejtja *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

69. Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. 360/4 prot., datë 09.09.2020, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e kërkuar, të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Sonila Bejtja:

- a) Nuk janë të regjistruar nga strukturat e Policisë së Shtetit për veprimtari kriminale ose të administrohen të dhëna për kontakte të papërshtatshme.

70. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. 583 prot., datë 28.02.2020, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi informacionin e klasifikuar e të përpunuar sipas standardeve ligjore dhe profesionale për këtë kategori informacionesh, të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese të cituara më sipër, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidaten Sonila Bejtja:

a) Nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 gërmat a dhe c, për integritetin e figurës së Znj. Sonila Bejtja, kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

71. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 - 93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidatja Sonila Bejtja në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të tij.

72. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati “*të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*”, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja Sonila Bejtja ka përfunduar studimet e larta në Universitë Degli Studi di Milano, Facoltà di Giurisprudenza, duke marrë titullin “*Dottore in giurisprudenza*”. Periudha e studimit është Tetori i vitit 1994 – Qershor i vitit 2000. Kandidatja ka paraqitur më datë 06.10.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi një kopje të noterizuar të Vërtetimit të Njohjes dhe Njësimit Nr. 1045, datë 22.12.2017 i Komisionit të Njohjes së Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka marrë në dorëzim këto akte me procesverbalin nr. 287 prot., datë 06.10.2020. Sipas përmbajtjes së vendimit të njohjes dhe njësimit, rezulton se diploma e kandidatës njësohet si Master i Shkencave në Republikën e Shqipërisë. Prandaj Këshilli vlerëson se ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidate Sonila Bejtja nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

73. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, konstatohet se kandidatja Sonila Bejtja nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit).

74. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, konstatohet se kandidatja Sonila Bejtja nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë kandidatja Sonila Bejtja nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara

75. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*. Nga shkresa nr. 2866 prot., datë 29.07.2020 e Dhomës Kombëtare të Noterisë drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezulton se kandidatja Sonila Bejtja, e cila është e licencuar si notere, ka ushtruar funksionin e noteres nga muaji prill 2011 dhe aktualisht dhe se nuk rezulton të ketë masa disiplinore ndaj saj. Gjithashtu nga shkresa nr. 200 prot., datë 19.08.2020 të Dhomës Kombëtare të Avokatisë rezulton se kandidatja, znj. Sonila Bejtja, nuk ka asnjë detyrim financiar dhe se ndaj saj nuk janë marrë masa disiplinore dhe se nuk ka asnjë procedim disiplinor në proces. Për rrjedhojë kandidatja Sonila Bejtja nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

76. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës Sonila Bejtja, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën në datën 22.11.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, shkronjës “e” të pikës 2, (të) pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidates Sonila Bejtja, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Sonila Bejtja.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, shkronjës “e” të pikës 2, (të) pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidates Sonila Bejtja, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Sonila Bejtja.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARI
Vitorë TUSHA

